



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-121282

Dt. 17.09.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë e investitori **NPN DRENARI Sh.P.K.** me seli në Prishtinë rr.Jashar Salihu Kulla e Muhaxhirre kati II nr.12 posedues **Shani dhe Salajdin Alishani** me LRP.nr.2886/2022 Ref.nr.450/2022 Kontrate mbi ndërtim të perbashket dhe LRP nr.22841/2023 nr.ref. 5613/2023 Aneks Kontrate mbi ndërtim të perbashket me të cilën kanë kërkuar leje për ndërtimin e objektit **banim kolektiv me lokale afariste** në bazë të nenit 3 alineja 1 pika 7 e lidhur me nenin 17 dhe 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-212 dt. 31.07.2013, si dhe nenit 3 alineja 1 pika 1.1, 1.4, 1.7, 1.10, 1.17, 1.20, 1.21 dhe të nenit 5 alineja 1 pika 1.1 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1.1 dhe në lidhje me nenin 15 alineja 1 pika 1.2 dhe nenit 19 alineja 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022, si dhe nenit 85 të LVL dhe të nenit 27, 44, 46, 47, 48 si dhe të nenit 125 të LPPA nr.05/031 dt.25.05.2016 si dhe konform nenit 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Udhezimit Administrativ nr.06.2017 dt.23.05.2017 si dhe konform nenit 4 pika 6.1, paragrafi 2 dhe paragrafi 14 si dhe konform nenit 34 e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr. 01/011-46063 dt.28.03.2019 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	investitor NPN DRENARI Sh.P.K. posedues Shani Alishani dhe Salajdin Alishani		
Adresa:	“//”, pn, //		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – banim kolektiv me afarizem		
Emri i projektuesit	Biro projektuese, “Forme Architects L.L.C.” Forme Architects&Partners		
Adresa:	rr.”Isa Kastrati 43/28” Prishtinë		
Telefoni:	044//	Emaili:	formearchitects@gmail.com

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore investitori **NPN DRENARI Sh.P.K.** me seli ne Prishtine rr.Jashar Salihu Kulla e Muhaxhirreve kati II nr.12 posedues **Shani dhe Salajdin Alishani nga Prizreni** lejohet ndërtimi i objektit në Prizren ne rrugën “//”, pn.//” - **banim kolektiv me afarizem** me etazhitet **2B+P+7 (me kaskade)** me numer ngastres P-71813068-11182-8 me sip366m², P-71813068-05201-3 me sip.693m², P-71813068-05200-5 me si 30m², P-71813068-05201-2 me sip.394m² Z.K.Prizren.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren-“//”,pn.//.	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar ndertime te banimit kolektiv afarizem ej. Objekti – <u>banim kolektiv me afarizëm</u> do të ndërtohet në parcelën me nr. 05200-5 05201-2,05201-3,11182-8 Z.K.Prizren , sip.1483m² sipas kopjes së planit. Etazhiteti i objektit do të jetë per <u>2B+P+7 (me kaskade)</u> Sipërfaqja bruto e bodrumit -II është S=576,0m². Neto e Bodrumit –II S=524.9m² Sipërfaqja bruto e bodrumit -I është S=576,0m². Neto e Bodrumit –I S=524.9m² Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=573.92m². Neto e Perdheses S=510.43m² Sipërfaqja bruto e katit I është S=574.87m². Neto e katit I S=485.04m² Sipërfaqja bruto e katit II është S=574.87m². Neto e katit II S=485.04m² Sipërfaqja bruto e katit III është S=574.87m². Neto e katit III S=492.41m² Sipërfaqja bruto e katit IV është S=526.97m². Neto e katit IV S=446.9m² Sipërfaqja bruto e katit V është S=479.06m². Neto e Katit V S=399.46m² Sipërfaqja bruto e katit VI është S=419.9m².	GPS Koordinatat:

	Neto e Katit VI S=348.79m² Sipërfaqja bruto e katit VII është S=419.9m². Neto e Katit VII S=348.79m² Sip.Neto te shk.korrid.kask. S=835.51m² Siperfaqja bruto e objektit S=5,296.36 m² Siperfaqja e objektit bruto per pagese eshte S=5,296.36m² Siperfaqja neto e objektit per pagese eshte S=3,841.93m² Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 28,842.12 €. Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 5,175.901.2€	
--	--	--

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindertim ☐ Ripatim ☐
Kategoria e ndertimeve te propozuera:	
Kategoria I	Kategoria II ☒
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Perdorimi i propozuar:objektit- banim kolektiv me afarizem	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **NPN DRENARI Sh.P.K.** me seli ne Prishtine rr.Jashar Salihu Kulla e Muhaxhirreve kati II nr,12 posedues **Shani dhe Salajdin Alishani nga Prizreni. - banim kolektiv me afarizem** me etazhitet **2B+P+7 (me kaskade)**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore.Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshëm të lejes ndertimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi gafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;

- Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
- Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
- Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
- Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
- Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **NPN DRENARI Sh.P.K.** me seli ne Prishtine rr.Jashar Salihu Kulla e Muhaxhirreve kati II nr,12 posedues **Shani dhe Salajdin Alishani nga Prizreni - banim kolektiv dhe afarizem** me etazhitet **2B+P+7 (me kaskade)** Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim per plotesim te dokumentacionit 04-353/01-58494,Dt.01.08.2022
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit te mbeturinave nga DSHP.
- Pëlqimi nga KRU”Dukagjini-Radoniqi” Sh.A.Gjakove.
- Pëlqim nga Drejtoria e Emergjences dhe Sigurise
- Leja Mjedisore Komunale
- Elaborati gjeomekanik i tokës ndertimore
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e II


Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë s Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-121282

Bashkepunetor profesional:

Zana Belloda inxh.dip.ark.



DREJTORI:

Pranverim Berisha,jur.